



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-030/01-21504/24, më 08 FEB 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës: nr. 28/04, qershor 2008), dhe nenit 53 shkronja (n) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr. 01-031-13761 i datës 19.01.2016 për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale, si në vijim:

1.1. Themelohet Drejtoria për Transformim e Kryeqytetit. Përgjegjësitë dhe organizimi i saj përcaktohen me vendim të veçantë.

1.2. Drejtoria e Pronës e përcaktuar në nenin 20 dhe 21 si dhe Drejtoria e Kadastrit e përcaktuar në nenin 28 dhe 29 të Vendimit nr. 01-031-13761 i datës 19.01.2016 fuzionohen në një drejtori të vetme me këtë emërtim “Drejtoria e Pronës dhe Kadastrit”.

1.3. Drejtoria e Urbanizmit e përcaktuar në nenin 22 dhe 23 si dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik e përcaktuar në nenin 32 dhe 33 të Vendimit nr. 01-031-13761 i datës 19.01.2016 fuzionohen në një drejtori të vetme me këtë emërtim “Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit”.

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen dispozitat e Vendimit me nr. 14-031/01-0112491/22 i dt. 20.05.2022 të cilat bien në kundërshtim me këtë Vendim.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

